



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:274702
Datë: 21.05.2024
Numri i dokumentit: 05752060

AA.nr.493/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Delushe Halimi, kryetare e kolegjit, Ramiz Kuqi dhe Hajriz Hoti, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë të paditëses H.A., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson R.D., avokat në P., kundër të paditurit Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), në Prishtinë, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.2604/18, të datës 12.05.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 21.05.2023, merr këtë;

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditëses H.A., e datës 20.06.2023, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore, në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.2604/18, të datës 12.05.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, me aktgjykimin e ankimuar, e refuzon si të pa bazuar, kërkesëpadinë e paditëses H.A., me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i të paditurës Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me nr.... i datës Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar i autorizuari i paditëses, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të; shkeljes qenësore të dispozitave të procedurës, vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë respektivisht Gjykata e Apelit këtë ankesë ta aprovoj si të bazuar në ligj dhe aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.2604/18, të datës 12.05.2023, të ndryshojë padinë dhe kërkesëpadinë ta aprovojë si të bazuar ose lëndën ta kthen në rivendosje, me rekomandim se nuk ka kompetencë lëndore në këtë çështje.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e lëndës, Aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 49, të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), dhe neni 194 i LPK-së, ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjen se;

Ankesa është e **pa bazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me Aktvendimin nr.ref.... i datës ..., ka aprovuar pjesërisht Ujdinë Jashtëgjyqësore të datës 05.06.2017 me të cilën z.J.T. i përfaqësuar nga H.A., avokate në P. është kompensuar për qëndrim në paraburgim pa bazë ligjore dhe pa arsye 1290.

Paditësja, e pa kënaqur me këtë vendim ka ushtruar padi në gjykatë me datë 30.10.2018, kundër të paditurit Këshilli Gjyqësor i Kosovës, duke pretenduar se vendimi i kontestuar është jo ligjor, duke kërkuar që të anulohet vendimi i KGJK-së. Gjykata e shkallës së parë, në këtë çështje ka mbajtur seancë të shqyrtimit kryesor, më datë 12.05.2023, në prani të paditëses dhe të autorizuarit të sajë palëve dhe përfaqësuesit të autorizuar të paditurës, dhe pas administrimit të provave si dhe shkresave tjera të lëndës merr aktgjykimin e ankimuar me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditëses si të pa bazuar, me arsyetimin ndër të tjera se: e paditura drejtë ka vepruar, ku sipas detyrës zyrtare ka anuluar aktin e saj konform nenit 53 par.1 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe me të drejtë e ka detyruar paditësen në kthimin e mjeteve (shumën prej 17,215.00 euro) të llogaritu për 1290 ditë, duke u mbështetur në nenin 59 të LPPA-së.

Qëndrimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në prova dhe ligj në tërësi e aprovon edhe Kolegji i Gjykatës së Apelit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje Gjykata e shkallës së dytë i vlerëson sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së, ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së. Kolegji vlerëson se Gjykata e shkallës së parë sipas kompetencës si në vështrim të nenit 9 dhe 44 të LKA-së, në mënyrë të drejtë ka shqyrtuar dhe vlerësuar ligjshmërinë e Vendimit të KGJK, të atakuar me padi, i cili vendim i ka të përmbledhura argumentet në të cilat është bazuar në arsyetimin e tij, ku janë dhënë arsye të mjaftueshme mbi faktet vendimtare në të cilat është bazuar, e të cilat Gjykata e Apelit njëjtë si Gjykata e shkallës së parë i aprovon si të drejta dhe ligjore.

Kolegji gjen se bazuar në provat e administruara në gjykatën e shkallës së parë, është vendosur drejt dhe janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për faktet vendimtare dhe bazat ligjore në të cilat bazohet aktgjykimi për refuzimin e kërkesë padisë së paditëses, sepse pa dyshim vërtetohet se, organi i paditur KGJK, drejtë ka vendosur duke u bazuar në nenin 53 par.1 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: *“Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që ka kompetenca të nxjerrë aktin, nga organi i tij mbikëqyrës apo nga një organ tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj”*, pra me të drejtë e ka anuluar pjesërisht aktin administrativ, pasi që ishte bërë llogaritja gabim e ditëve të qëndrimit në paraburgim të J.T., kjo vërtetohet nga Aktgjykimi i gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr.351/14 i datës 23.10.2015 me të cilin aktgjykim J.T. autorizimdhënësi i paditëses, ishte shpallur fajtor dhe është dënuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 2 vite e 10 muaj, e në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej datës 28.11.2010 deri më datë 13.06.2014. Ndërsa me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAKR.nr.134/2016 është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë. Po ashtu nga vërtetimin i Shërbimit Korrektues-Qendra Korrektuese-Dubravë, të datës 16.02.2014, janë konfirmuar ditët e qëndrimit të tij në paraburgim nga data 28.11.2010 deri me datë 13.06.2014. Nga këto prova me të drejtë e paditura dhe gjykata e shkallës së parë kanë vlerësuar se J.T., ka

qëndruar në paraburgim nga data 28.11.2010 e deri më datë 13.06.2014 pra gjithsejtë 1290 ditë. Mirëpo, duke llogaritur dënimin me burgim (2 vite e 10 muaj), i bije që njëjti në paraburgim ka qëndruar gjithsejtë 259 ditë, sepse pjesën tjetër të ditëve e ka mbajtur në burg për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor. Nga kjo kuptohet se e paditura gabimisht ka llogaritur ditët e qëndrimit duke e llogaritur gjithë periudhën e qëndrimit në burg 1290. Andaj duke u bazuar në të lartcekurat me të drejtë e paditura e ka detyruar paditësen në kthimin e mjeteve (shumën prej 17,215.00 euro) të llogaritur për 1290 ditë, duke u mbështetur në nenin 59 të LPPA-së.

Pretendimet ankimore të paditësit nga bazat ankimore të cekura më lartë, Kolegji i shqyrtoi në tërësi dhe i vlerëson se janë të pa bazuara, të pa qëndrueshme apo pa ndikim për vendosjen e çështjes në mënyrë tjetër, sepse nuk argumentohet me asnjë provë se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, sepse nga gjykata e shkallës së parë dhe organi i paditur si në vendimet e tyre janë treguar dhe arsyetuar në tërësi faktet vendimtare të bazuara edhe në bazat ligjore. Nga këto fakte rezulton se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë, në bazë të pretendimeve të palëve si dhe provave materiale të gjendjes konkrete, nga se nga shkresat e lëndës vërtetohet se është bërë gabim në llogaritjen e ditëve të paraburgimit për J.T. dhe me të drejtë e paditura e ka anuluar pjesërisht Ujdinë Jashtëqyësore të datës 05.06.2017 me të cilën i njëjti është kompensuar për qëndrimin në paraburgim pa bazë ligjore dhe pa arsye 1290 ditë ndërsa është dashur të kompensohet për qëndrimin e tij në paraburgim pa bazë ligjore dhe pa arsye për 259 ditë.

Bazuar në theksimet dhe dispozitat e cekura më lartë, kolegji i kësaj gjykate, vlerëson se si organi i paditur KGJK, ashtu edhe gjykata e shkallës së parë, bazuar nga provat që gjenden në shkresat e lëndës drejtë kanë vepruar me rastin e marrjes së vendimeve, e të cilat si të drejta dhe të bazuara i pranon edhe kjo gjykatë, andaj nuk mund të konstatohet se është shkelur ligji në dëme të paditësit, e që në kuptim të nenit, 49 të LKA-së, dhe neni 200 i LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.493/2023, me datë 21.05.2024

Kryetare e Kolegjit,
Delushe Halimi